

PROCEDURA DHE RREGULLAT PER RREGJISTRIMIN E TE GJITHE STUDENTEVE TE RREGULLT TE VITIT

II & III, NE SEZONIN E TE MBARTURAVE 2015-2016

Keto rregulla jane unike per te gjithë studentet e rregullt te viteve te dyta dhe te treta, ne te gjitha ciklet e studimit: BA-KP,BA-PT,MP dhe MSC.

Per sezonin e te mbarturave 2015-2016 kane te drejte te rregjistrohen vetem studentet e vitit te dyte dhe te trete te cilet jane te regjistruar paraprakisht ne vitin akademik 2015-2016 dhe kane provime te mbartura nga viti akademik 2013-2014 apo 2014-2015.

Theksojme se ne kete sezon keta studente mund te japin vetem provime nga lendet te cilat nuk i kane mare gjate viteve akademike te meparshme 2013-2014, 2014-2015.

Studentet duhet te rregjistrohen vete ne lendet qe do te japin provim. Me poshte tregohet rregullat dhe procedura e rregjistrimit.

1. Sezoni i te mbarturave per vitin akademik 2015-2016 eshte: 15 mars - 19 mars 2016.
 2. Sa data provimesh do te jene ?.....(3)
 3. Per nje lende te caktuar sa data provimesh do te lihen ?.....(1)
 4. Ne sa provime do te futet studenti ne nje dite ?.....(deri ne 2 provime)
 5. Sa provime mund te jape studenti ne sezonin e te mbarturave?.....(deri ne 3)
 6. Studenti mund te prenotohet vetem nje here per te njejtin provim.
 7. Per sezonin e te mbarturave rregjistrimi i studenteve per provime do te perfshije periudhen 9 mars – 13 mars 2016.
- Sekretarite mesimore duhet te pergatitin paraprakisht grafiket e provimeve.
8. Pas kesaj date asnje student nuk mund te kryeje veprime per rregjistrime ne provimet e sezonit te te mbarturave 2015-2016.
 9. Ne provimet e sezonit te te mbarturave 2015-2016 nuk do te futen studentet qe s'kane paguar.
 10. Kujtojme se per tu rregjistruar ne sezonin e te mbarturave, te gjithë studentet duhet te jene te pasjitur me te dhenat qe ata kane vendosur vete per te hyre ne sistemin e digjital.
 11. N.q.s studentet kane problem me keto te dhena atehere te komunikojne sa me shpejt me sekretarite mesimore te fakultetit perkates per tu njohur me to.
 12. Menyra e rregjistrimit ne provimet e sezonit te te mbarturave 2015-2016 eshte njesoj sikurse dhe ajo e sezonit te vjeshtes 2014-2015.
 13. Ne sezonin e te mbarturave pedagogu qe merr studentet ne provim, eshte ai qe eshte percaktuar ne kurrikulen e studimeve te atij viti akademik (2015-2016) dhe jo pedagogu i vitit te kaluar.
 14. Per te gjithë studentet te cilet duan te japin ne sezonin e te mbarturave 2015-2016 lende te cilat i kane patur te pafrekuentura gjate vitit akademik 2013-2014, 2014-2015, por i kane frekuentuar gjate sem I te vitit akademik 2015-2016 duhet :

a. Te kerkojne nga pedagogu i lendes qe para sezonit, vendosjen e frekuentimit te lendes ne sistemin dixhital te vleresimit. Ne te kundert studenti nuk do te mund te prenotohet nga websiti i tij ne provimin e kesaj lende per kete sezon.

b. Studenti shkon ne websitin e tij dhe rregjistrohet, ose kur data e rregjistrimit ka kaluar por provimi ende nuk eshte zhvilluar, pedagogu (nese e sheh te mundshme) mund ta shtoje studentin ne procesverbalin e provimit pasi ka verifikuar me pare ne sekretarine mesimore nese ai ka shlyer pagesat.

Kujdes**. Pas dates se provimit studentet nuk mund te rregjistrohen per provim ne kete sezon.**